



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.118

14 gusht

2009

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr.6223 datë 20.7.2009	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare 5645
Vendim i KM nr.748, datë 11.6.2009	Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë 5645
Vendim i KM nr.753, datë 8.7.2009	Për kalimin në pronësi, nga “Albpetrol”, sh.a.-ja, bashkisë Patos, të ndërtesës së ish-Institutit Teknologjik të Naftës dhe Gazit (ITNG) dhe për një shtesë në vendimin nr.813, datë 29.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Patos, të qarkut të Fierit” 5647
Vendim i KM nr.756, datë 8.7.2009	Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Brendshme, të sipërfaqes 600 m ² , pjesë e pronës nr.837 “Shtabi i brigadës së këmbësorisë”, Fier, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar..... 5650
Vendim i KM nr.757, datë 8.7.2009	Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të pronës nr.265 “Ish-shtëpia e ushtarakëve”, Elbasan, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar 5652

Vendim i KM nr.758, datë 8.7.2009	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për ripranimin e personave	5652
Vendim i KM nr.759, datë 8.7.2009	Për përballimin e shpenzimeve të punonjësve shqiptarë, që shërbejnë si oficerë kontakti pranë ministrive të brendshme të shteteve të ndryshme, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë	5657
Vendim i KM nr.760, datë 8.7.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.37, datë 28.1.2002 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e repartit të inspektim-shpëtimit në miniera”, të ndryshuar	5658
Vendim i KM nr.768, datë 15.7.2009	Për miratimin e procedurave e të rregullave për kandidimin dhe përzgjedhjen e anëtarëve të brodit mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)	5661
Vendim i KM nr.769, datë 15.7.2009	Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.....	5665
Vendim i KM nr.770, datë 15.7.2009	Për përcaktimin e mënyrave, të formave, kritereve dhe të rregullave shtesë, për organizimin e lojërave të fatit, promocionale.....	5675
Vendim i KM nr.772, datë 15.7.2009	Për dhënie fondi ndihme partisë “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”.....	5677
Vendim i KM nr.774, datë 17.7.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të gjashtë automjeteve dhe tetëmbëdhjetë trupave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.....	5678
Vendim i KM nr.775, datë 8.7.2009	Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen e koncesionit të formës “BOO”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe “Hidroinvest”, sh.p.k.-së, Çarshovë, Përmet, për ndërtimin e hidrocentraleve në Stranik dhe Zall Tore, në komunën Stravaj, Librazhd”, dhe për disa ndryshime në vendimin nr.565, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave	5679
Vendim i KM nr.776, datë 15.7.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.....	5686
Vendim i KM nr.777, datë 15.7.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Krrabë të qarkut të Tiranës.....	5686
Vendim i KM nr.778, datë 15.7.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Lekaj të qarkut të Tiranës.....	5687

Vendim i KM nr.780, datë 15.7.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Krahës të qarkut të Gjirokastrës.....	5689
Vendim i KM nr.781, datë 15.7.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, e cila preket nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare, në bashkinë Kamëz (Bathore 5), Tiranë..	5690
Vendim i KM nr.782, datë 15.7.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, e cila preket nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare, në bashkinë Kamëz (Bathore 6), Tiranë..	5691
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Beqir Jonuz Dunga.....	5692

DEKRET
Nr.6223, datë 20.7.2009

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Gema Luan Guri
2. Besa Bali Kurtaj
3. Arian Eftim Llazari
4. Elona Josif Kole
5. Christ Rafael Arian Llazari
6. Ray Martin Arian Llazari
7. Petrit Isak Allaraj
8. Tauland Shemsi Sadikaj
9. Hysen Nezir Hasmeta
10. Zhaneta Niko Hasmeta (Kapedani)
11. Mario Hysen Hasmeta
12. Gloria Hysen Hasmeta

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.748, datë 11.6.2009

PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT AKADEMIK TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 47 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave, sipas kategorive të vendeve të punës, për nëpunësit e institucioneve publike të arsimit të lartë të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, përfiton shtesë për vjetërsi në punë, në masën 0.5 për qind, për çdo vit pune, por jo më shumë se për 15 vjet.

3. Kur një anëtar i personelit akademik, për nevoja të procesit mësimor, punësohet në një vend pune, me kërkesa më të ulëta se kualifikimi që ai ka, do ta përfitojë pagën, sipas vendit të punës, dhe një shpërblim prej 50 për qind të diferencës së pagës, që do të merrte në përputhje me kualifikimin, me pagën sipas vendit të punës.

4. Kur një anëtar i personelit akademik, për nevoja të procesit mësimor, punësohet në një vend pune, me kërkesa më të larta se kualifikimi që ka, do ta përfitojë pagën sipas klasifikimit të tij/saj.

Në të dyja rastet e sipërpërmendura, këto forma pagesash nuk mund të vazhdojnë më shumë se periudha tranzitore, sipas ligjit për arsimin e lartë, për kategorizimin e anëtarëve të personelit akademik, në përputhje me kualifikimin e secilit dhe me kërkesat e çdo vendi pune.

5. Shpërblimi i personelit akademik dhe i anëtarëve të jashtëm, për pjesëmarrje në këshillin e administrimit, senatin akademik, këshillin e fakultetit, këshillin e profesorëve, kryhet çdo 6 muaj dhe është në masën 8000 (tetë mijë) lekë në muaj, me kusht, që të kenë marrë pjesë në të paktën gjysmën e mbledhjeve të zhvilluara për këtë periudhë.

6. Kategorizimi i personelit akademik brenda çdo klase bëhet në përputhje me klasifikimin e vendeve të punës në universitete dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kategoritë e pagave për pozicionet e punës me titull të njëjtë përcaktohen në kuadër të miratimit të strukturës dhe të organikës të secilit institucion.

7. Anëtarët e personelit akademik efektivë, që, për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi mbi normën mësimore vjetore, të miratuar me aktet përkatëse, për çdo orë mësimi, të kryer mbi këtë normë, paguhen, si më poshtë vijon:

a) Kur janë në kategorinë “Profesor”, përfitojnë 1200 (një mijë e dyqind) lekë për çdo orë 60 – minutëshe;

b) Kur janë në kategorinë “Profesor i asociuar”, përfitojnë 1100 (një mijë e njëqind) lekë për çdo orë 60 – minutëshe;

c) Kur janë në kategorinë “Docent”, përfitojnë 1000 (një mijë) lekë për çdo orë 60 – minutëshe;

ç) Kur janë “Lektor i parë”, përfitojnë 800 (tetëqind) lekë për çdo orë 60 – minutëshe;

d) Kur janë “Lektor”, përfitojnë 600 (gjashtëqind) lekë për çdo orë 60 – minutëshe.

8. Punonjësit e specialiteteve të ndryshme, të punësuar në institucione të tjera shtetërore, me kohë të plotë, por që japin mësim në institucionet publike të arsimit të lartë, si anëtarë të jashtëm të personelit akademik, për çdo orë mësimi 60-minutëshe të paguhen në të njëjtën masë me punonjësit efektivë të këtyre institucioneve.

9. Personeli akademik me kontratë, në cilësinë e personaliteteve, vendase ose të huaja, të paguhen me honorarë për ditë/orë pjesëmarrjeje në procesin e mësimdhënies në institucionet publike të arsimit të lartë. Përcaktimi i masës së honorarëve bëhet me vendim të rektoratit, pasi të jetë miratuar më parë në këshillin e administrimit. Masa e pagesës nuk duhet të jetë më e madhe se 5-fishi i pagesës për orët mbi normën, për kategorinë “Profesor”.

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtyre pagesave, të përballohen nga të ardhurat e veta, të çdo institucioni të arsimit të lartë publik.

10. Funkionarët dhe nëpunësit, që përfshihen në fushën e veprimt të këtij vendimi, nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë, të përcaktuara me vendime të tjera të Këshillit të Ministrave.

11. Vendimi nr.1231, datë 2.7.2008 i Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, nuk do të zbatohet për personelin akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë.

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për universitete dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë, në buxhetin e vitit 2009.

13. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e fillimit të vitit të ri akademik, 2009-2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT
AKADEMIK, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

Nr.rendor	Pozicioni	Paga
1	Rektor (Titullar institucioni)	125 000
2	Zëvendësrektor, nga kategoria “Profesor”	120 000
3	Zëvendësrektor, nga kategoria “Docent”	118 000
4	Dekan nga kategoria “Profesor”	120 000
	Dekan nga kategoria “Docent”	118 000
5	Zëvendësdekan nga kategoria “Profesor”	107 000
6	Zëvendësdekan nga kategoria “Docent”	95 000
7	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Profesor”	107 000
8	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Docent”	95 000
9	Profesor	103 500
10	Profesor i asociuar	90 000
11	Docent	80 000
12	Lektor i parë/kërkues i parë	77 000
13	Lektor/kërkues	61 000

VENDIM
Nr.753, datë 8.7.2009

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA “ALBPETROL”, SHA-JA, BASHKISË PATOS, TË
NDËRTESES SË ISH-INSTITUTIT TEKNOLOGJIK TË NAFTËS DHE GAZIT (ITNG) DHE
PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.813, DATË 29.11.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE NË BASHKINË PATOS, TË QARKUT TË FIERIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 5 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga “Albpetrol”, sh.a., bashkisë Patos, të ndërtesës së ish-Institutit Teknologjik të Naftës dhe Gazit (ITNG), me vendndodhje në qytetin e Patosit, sipas genplanit dhe fletinventarit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.813, datë 29.11.2007 të Këshillit të Ministrave, pas numrit 210 shtohet numri 211, me këtë emërtim “Ndërtesa e ish-Institutit Teknologjik të Naftës e Gazit (ITNG), me vendndodhje në Patos.”.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, “Albpetrol”, sh.a., bashkia Patos dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Shk. 1:500

DREJTORI I INSTITUTIT TENAFYES

DR. (STAVRI DHINA)

SPJEGUESI.

Zyra laboratore

Zyra laboratore

1. KT

Ofiçinë

Methods

Methods

Kufiri i Proneise te "IN. FIER

Kufiri i Pronesise te IN. FIER

Sipërfaqe e përqithëshme e Objektit

... e përqithëshme e objektit

Suprafața e zăă" me Obiecte 1082.

e rënë me Objekte 1982.

PERGJEGJESI URBANISTIKE BASHKI /

()

Puno: topograf

Ing. (Vasil Peci)

1. FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Albpetrol sh.a. Bashkia/komuna: Patos Fusha e përdorimit të pronës: administratë										
Nr. rend.	A			B			C			
	Zona kadast. & Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës m ²	Nga sip. totale sa ndërtesë m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ enti përdorues. Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1.	-	-	Truall Ndërtesë	Godina e ITNG Patos	3488	1082	Administratë	METE	Albpetrol sh.a.	Ndërtesë dy kate

VENDIM
Nr.756, datë 8.7.2009

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË SË BRENDSHME, TË SIPËRFAQES 600 M², PJESË E PRONËS NR.837 “SHTABI I BRIGADËS SË KËMBËSORISË”, FIER, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Brendshme, të sipërfaqes 600 (gjashtëqind) m², pjesë e pronës nr.837 “Shtabi i brigadës së këmbësorisë”, Fier, për t’u përdorur nga komisarati i policisë, Fier.

2. Sipërfaqja, e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar me vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministrisë së Brendshme i ndalohet t’i ndryshojë destinacionin pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RELIEVI I TERITORIT TE REP. USHT.

Nr. 6600. FIER

(ISH SHTABI BRIGADES KEMBESORISE)

SHK: 1:500



VENDIM
Nr.757, datë 8.7.2009

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS, TË PRONËS NR.265 “ISH-SHTËPIA E USHTARAKËVE”, ELBASAN, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të pronës nr.265 “Ish-shtëpia e ushtarakëve”, Elbasan, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

2. Prona e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar me vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i ndaloheq që pronës së përcaktuar në këtë vendim, t’i ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.758, datë 8.7.2009

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për ripranimin e personave, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Kosovës, të quajtura më poshtë “Palë kontraktuese”,

me dëshirën për të zhvilluar marrëdhënie miqësore midis të dy shteteve;

të udhëhequra nga qëllimi për të bashkëpunuar në bazë të reciprocitetit në trajtimin e çështjeve të ripranimit të personave, që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme të territorin e palës tjetër kontraktuese;

me dëshirën për të kontribuar në këtë mënyrë në parandalimin e lëvizjes së paligjshme të personave dhe në përputhje me parimet e bashkëpunimit europian, si dhe në përputhje me interesat reciproke,

ranë dakord për sa vijon:

I

RIPRANIMI I SHTETASVE TË PALËVE KONTRAKTUESE

Neni 1

1. Secila palë kontraktuese do të ripranojë në territorin e saj, me kërkesën e palës tjetër kontraktuese dhe pa formalitete të tjera, personin që qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e palës kontraktuese kërkuese, nëse provohet ose prezumohet në mënyrë të vlefshme se personi zotëron shtetësinë e palës kontraktuese të kërkuar. Përgjigjja e palës kontraktuese të kërkuar, në lidhje me ripranimin e personit, do të dërgohet pa vonesë, por jo më vonë se 28 ditë kalendarike nga marrja e kërkesës për ripranim.

2. Pala kontraktuese kërkuese do të ripranojë personin të referuar në paragrafin 1, sipas të njëjtave dispozita, nëse më vonë, në bazë të hetimeve të mëtejshme, përcaktohet se në kohën kur ai/ajo u transferua nga territori i shtetit të palës kërkuese ai/ajo nuk e zotëronte shtetësinë e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar.

3. Në rastin kur personi i përmendur në paragrafin 1 transferohet dhe ka nevojë për kujdes të veçantë për arsye të moshës së tij/saj, gjendjes së keqe shëndetësore ose për ndonjë arsye tjetër të rëndësishme, çdo palë kontraktuese informon për këtë palën tjetër kontraktuese.

Neni 2

1. Nëse shtetësia është provuar ose prezumuar në mënyrë të vlefshme, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor i palës kontraktuese të kërkuar do të lëshojë pa vonesë, me kërkesë të palës kontraktuese kërkuese, një dokument udhëtimi zëvendësues, që është i nevojshëm për kthimin e personit që do të transferohet në përputhje me nenin 1, paragrafi 1.

2. Kur ka dyshime për vlefshmërinë e shtetësisë së prezumuar, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor i palës kontraktuese të kërkuar do ta intervistojë personin brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga dorëzimi i kërkesës për ripranimin e personit. Nëse intervistimi tregon se personi ka shtetësinë e palës kontraktuese të kërkuar, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor do të lëshojë menjëherë një dokument udhëtimi zëvendësues.

II

RIPRANIMI I SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI

Neni 3

1. Nëse personi që ka hyrë në territorin e palës kontraktuese kërkuese nuk arrin t'i përmbushë kushtet paraprake në fuqi për hyrje apo qëndrim, dhe nëse ky person ka një vizë të vlefshme ose një leje të vlefshme qëndrimi të lëshuar nga pala kontraktuese e kërkuar, kjo e fundit do ta ripranojë atë me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese dhe pa asnjë formalitet.

2. Nëse të dyja palët kontraktuese kanë lëshuar një vizë ose një leje qëndrimi, detyrimi për të ripranuar personin do t'i kalojë asaj pale kontraktuese, vlefshmëria e vizës ose lejes së qëndrimit të së cilës mbaron më vonë.

Neni 4

1. Pala kontraktuese e kërkuar do ta ripranojë një shtetas të vendeve të treta apo person pa shtetësi me kërkesën e palës kontraktuese kërkuuese, nëse kjo e fundit provon apo prezumon vlefshmërisht se personi, i cili nuk i plotëson kërkesat efektive për hyrje apo qëndrim, e ka kaluar kufirin shtetëror të palës kontraktuese kërkuuese, pasi ka qëndruar në territorin e palës kontraktuese të kërkuar.

2. Detyrimi për të ripranuar, sipas paragrafit 1, nuk do të zbatohet ndaj një personi, i cili në kohën e hyrjes së tij/saj në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuuese kishte një leje qëndrimi të vlefshme të lëshuar nga ajo palë kontraktuese, ose të cilit i ishte dhënë leje qëndrimi nga ajo palë kontraktuese pas hyrjes së tij/saj.

3. Palët kontraktuese do të bëjnë përpjekje, sipas parapëlqimeve, për të transferuar një shtetas të një vendi të tretë për në shtetin e tij/saj të origjinës.

4. Pala kontraktuese kërkuuese do të ripranojë një shtetas të një shteti të tretë ose një person pa shtetësi nën të njëjtat kushte, nëse më pas përcaktohet se në kohën e transferimit të tij/saj nga territori i shtetit të palës kontraktuese kërkuuese, nuk plotësoheshin kushtet në kuadrin e nenit 3, paragrafi 1 dhe nenit 4, paragrafi 1.

Neni 5

Detyrimi për të ripranuar sipas neneve 3 dhe 4 nuk do të zbatohet për një shtetas nga vendet e treta ose për një person pa shtetësi:

a) të cilit i është dhënë statusi i refugjatit nga pala kontraktuese kërkuuese, në bazë të Konventës për Statusin e Refugjatëve (Gjenevë, 28 korrik 1951) dhe protokollit për Statusin e Refugjatëve (Nju-Jork, 31 janar 1967);

b) i cili është transferuar më parë nga pala kontraktuese e kërkuar për në shtetin e origjinës ose në ndonjë shtet tjetër;

c) shteti i të cilit ka kufi të përbashkët me shtetin e palës kontraktuese kërkuuese;

d) që ka qëndruar në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuuese për më shumë se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë.

III

PRANIMI TRANZIT I SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI

Neni 6

1. Secila nga palët kontraktuese, me kërkesë me shkrim të palës tjetër, autorizon tranzitimin në territorin e vet të shtetasve të vendeve të treta, të cilët i janë nënshtruar masës së largimit të ndërmarrë nga pala kontraktuese kërkuuese. Tranziti mund të kryhet në rrugë tokësore ose ajrore.

2. Pala kontraktuese kërkuuese është përgjegjëse për vazhdimin e mëtejshëm të udhëtimit të shtetasit të një vendi të tretë drejt vendit të destinacionit dhe rimerr përsipër shtetasin në fjalë, nëse për çfarëdo arsye ripranimi i tij nuk zbatohet.

3. Pala kontraktuese kërkuuese i garanton palës kontraktuese të kërkuar që shtetasi i vendit të tretë, për të cilin autorizohet tranziti, ka një dokument (biletë) udhëtimi për në vendin e destinacionit.

4. Në rast të tranzitit në rrugë ajrore, pala kontraktuese e kërkuar mund të sigurojë, nëse është e nevojshme, mbikëqyrjen e personit në zonën tranzit të aeroportit dhe sistemin e tij në bord të avionit, në marrëveshje me personelin shoqërues të palës kontraktuese kërkuuese.

Neni 7

1. Tranziti mund të refuzohet, nëse një shtetas i një vendi të tretë është në rrezik për:
 - a) persekutim në vendin e destinacionit për arsye race, feje, kombësie, anëtarësie në një grup shoqëror të caktuar ose për arsye të pikëpamjeve të tij/saj politike;
 - b) ndjekje penale në vendin e destinacionit ose ekzekutimin e një dënimi të dhënë për një vepër penale të kryer para se të ndodhte tranziti;
 - c) për arsye të shëndetit publik, sigurisë së brendshme, rendit publik ose interesave të palës kontraktuese të kërkuar.

IV SHPENZIMET

Neni 8

1. Shpenzimet që lidhen me ripranimin e personave sipas nenit 1, paragrafi 1 dhe nenit 4, paragrafi 1 deri në momentin që kryhet marrja në dorëzim e personit nga autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar, mbulohen nga pala kontraktuese kërkuuese. Shpenzimet në lidhje me kthimin e mundshëm të personave për t'u ripranuar mbulohen gjithashtu nga pala kontraktuese kërkuuese.
2. Shpenzimet e transferimit të një shtetasi të një vendi të tretë deri në kufirin e vendit të destinacionit, duke përfshirë shpenzimet që lidhen me tranzitin përmes territorit të Palës kontraktuese të kërkuar, si edhe shpenzimet që lidhen me një kthim të mundshëm të tij/saj mbulohen nga Pala kontraktuese.

V MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 9

1. Të dhënat personale të komunikuara, të cilat janë të nevojshme për qëllim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të mbrohen në përputhje me legjislacionin e brendshëm të palëve kontraktuese.
2. Nëse zbatimi i kësaj Marrëveshjeje kërkon shkëmbim të dhënash personale ndërmjet palëve kontraktuese, për personat, këto të dhëna mund të jenë vetëm në lidhje me:
 - a) të dhënat personale të personit që duhet të transferohet ose të pranohet, të të afërmeve të tij/saj (emri, mbiemri, emra të mëparshëm, pseudonime, emra të rremë, data dhe vendi i lindjes, gjinia, shtetësia);
 - b) pasaportën, kartën e identitetit, dokumente të tjera të identitetit ose dokumente udhëtimi dhe lejkalimi (numri, data e skadimit, data e lëshimit, autoriteti lëshues, vendi i lëshimit);
 - c) të dhëna të tjera të nevojshme për të identifikuar personin, që do të transferohet apo do të pranohet;
 - d) vendin e qëndrimit dhe itinerarin;
 - e) lejeqëndrim ose viza të lëshuara nga njëra prej palëve kontraktuese.

VI DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 10

1. Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës do të lidhin një protokoll zbatimi në të cilin ato do të specifikojnë:

- a) dokumentet që provojnë apo prezumojnë në mënyrë të vlefshme shtetësinë e shteteve të palëve kontraktuese;
- b) përmbajtjen e kërkesave për ripranimin dhe tranzitimin, mënyrën e paraqitjes dhe përpunimit të tyre;
- c) mjete për të provuar apo për të prezumuar në mënyrë të vlefshme hyrjen apo qëndrimin në territorin e shtetit të palës kontraktuese;
- d) autoritetet kompetente të autorizuar për të zbatuar këtë Marrëveshje;
- e) pikat e kalimit kufitar të përdorura për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

1. Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese, të autorizuar për të zbatuar këtë Marrëveshje, bashkëpunojnë dhe konsultohen drejtpërsëdrejti.
2. Në rast vështirësish në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, kërkesa për konsultim duhet të paraqitet përmes kanaleve diplomatike.
3. Secila palë kontraktuese do të caktojë të paktën dy ekspertë për të vlerësuar realizimin e Marrëveshjes dhe, nëse është e nevojshme, për të paraqitur propozime për zgjidhjen e çështjeve që lidhen me zbatimin e saj. Në të tilla shqyrtime mund të ftohen gjithashtu edhe ekspertë të tjerë për fusha të interesuara.

Neni 12

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë detyrimet në lidhje me pranimin ose transferimin e shtetasve të vendeve të treta, detyrime që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare për palët kontraktuese.
2. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk pengojnë zbatimin e dispozitave të Konventës për Statusin e Refugjatëve (Gjenevë, 28 korrik 1951) dhe Protokollit për Statusin e Refugjatëve (Nju Jork, 31 janar 1967).
3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk pengojnë zbatimin e marrëveshjeve të firmosura nga palët kontraktuese në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Neni 13

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar. Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas ditës së shkëmbimit të njoftimeve nga palët kontraktuese, nëpërmjet të cilëve ato njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e kërkesave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
 2. Secila palë kontraktuese mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, plotësisht ose pjesërisht, me përjashtim të nenit 1, për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, rendit publik apo shëndetit publik. Palët kontraktuese do ta njoftojnë njëra-tjetrën pa vonesë për marrjen e kësaj mase apo për anulimin e saj nëpërmjet kanaleve diplomatike. Pezullimi i zbatimit të Marrëveshjes do të hyjë në fuqi me dorëzimin e njoftimit palës tjetër kontraktuese.
 3. Secila palë kontraktuese mund ta denoncojë me shkrim Marrëveshjen nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, Marrëveshja do të përfundojë në ditën e nëntëdhjetë pas dorëzimit të njoftimit për përfundimin palës tjetër kontraktuese.
- Bërë në ----- më -----në dy kopje origjinale, secila prej të cilave në gjuhën shqipe, serbe dhe në gjuhën angleze, të dy tekstet të barasvlefshme. Në rast mospërputhje në interpretim, do të mbizotërojnë teksti në gjuhën angleze.

VENDIM
Nr.759, datë 8.7.2009

**PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË PUNONJËSVE SHQIPTARË, QË SHËRBEJNË
SI OFICERË KONTAKTI PRANË MINISTRIVE TË BRENDSHME TË SHTETEVE TË
NDRYSHME, TË ATASHUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Brendshme, brenda fondeve buxhetore vjetore, të miratuara për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të përballojë shpenzimet e punonjësve shqiptarë, që shërbejnë si oficerë kontakti pranë ministrive të brendshme të shteteve të ndryshme, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, për shpenzime:

- a) publicitare, në interes të Policisë së Shtetit;
- b) për udhëtime dhe dieta jashtë vendit pritës, kur këto kryhen në interes të Policisë së Shtetit;
- c) për pritjen e partnerëve zyrtarë, në vendin pritës;
- ç) për ceremonitë zyrtare, të karakterit policor, në vendin pritës;
- d) për pritje të personelit policor, të nivelit të lartë;
- dh) për udhëtime dhe dieta, brenda vendit pritës;
- e) për mbështetjen e veprimtarive, veçanërisht të rëndësishme, të studentëve të policisë shqiptare, në vendet përkatëse;
- ë) për uniformën;
- f) për qiranë e apartamentit, mirëmbajtjen e tij, për ngrohje, gaz, energji elektrike dhe ujë;
- g) për pajisje shtëpiake;
- gj) për siguracion, mirëmbajtje dhe parkim automjeti;
- h) për karburant;
- i) për siguracion shëndetësor familjar;
- j) për taksa të shkollave publike, komisione bankare;
- k) për telefoninë fikse dhe të lëvizshme;
- l) për zyrë dhe kancelari.

Për shpenzime, që janë të përshtatshme të kryhen në vendin pritës, oficeri i kontaktit dërgon ofertat në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila përzgjedh dhe miraton ofertën më të përshtatshme, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin e prokurimit publik, të ndryshuar.

2. Kur oficeri i kontaktit dërgohet me shërbim jashtë shtetit pritës ose kur vjen në atdhe, ndërkohë që në shtetin ku kryen detyrën ka lënë bashkëshorten dhe fëmijët, merr 100 për qind të trajtimit financiar, të dhënë për përkujdesje ndaj familjes së tij.

3. Kur oficeri i kontaktit shtrohet për kurim në institucionet shëndetësore të shtetit, ku kryen detyrën ose në ndonjë shtet tjetër, ai vazhdon ta përfitojë pagesën përkatëse dhe trajtimin financiar, të dhënë për përkujdesjen ndaj familjes së tij.

4. Oficeri i kontaktit gëzon të drejtën e pushimeve javore, të pushimeve në ditët e festave zyrtare dhe të pushimit vjetor të paguar, për kohën që është me detyrë jashtë shtetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ministria e Brendshme nuk merr përsipër shpenzimet e kthimit në atdhe të oficerit për kryerjen e lejes së zakonshme. Me miratimin e Ministrit të Brendshëm, vetëm në rast fatkeqësie, oficerit të kontaktit dhe familjarëve shoqëruar, u paguhen nga shteti shpenzimet e udhëtimit (për ardhjen në atdhe dhe kthimin në vendin e huaj).

5. Ministria e Brendshme, për oficerët e kontaktit dhe pjesëtarët e familjes, që janë në ngarkim të tyre, përballon sigurimet e detyrueshme, sipas legjislacionit të shtetit përkatës, ku ata kryejnë detyrën. Oficeri i kontaktit dhe pjesëtarët e familjes, në ngarkim të tij, kanë të drejtë, që, me miratimin e eprorit direkt dhe sipas rregullave të Policisë së Shtetit, për raste urgjencash, të mjekohen në vendin, ku oficeri kryen detyrën, kur, për këtë rast, nuk është parashikuar siguri shëndetësor. Shpenzimet përballohen nga shteti, ndërsa për rastet e tjera përballohen nga vetë oficeri i kontaktit.

6. Oficeri i kontaktit ka të drejtë të përfitojë shpenzime udhëtimi, akomodimi dhe dietë, në valutë të huaj, sipas legjislacionit në fuqi, kur emërohet në detyrë, thirret në atdhe ose dërgohet me shërbim në një shtet tjetër, si dhe kur kthehet në atdhe, në përfundim të detyrës.

7. Ministria e Brendshme, brenda fondeve buxhetore vjetore, të miratuara për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, përballon efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

8. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.760, datë 8.7.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.37, DATË 28.1.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E REPARTIT TË
INSPEKTIM-SHPËTIMIT NË MINIERA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr.8741, datë 15.2.2001 “Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 10 e vendimit nr.37, datë 28.1.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Struktura organizative e repartit të inspektim-shpëtimit në miniera (RISHM) të jetë sipas pasqyrës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Vendimi nr.744, datë 9.11.2006 i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA E REPARTIT INSPEKTIM SHPËTIM MINIERA

INDEKS	EMËRTIMI	POZICIONI	KATEG.	ARSIMI	PROFESIONI	NR.
A	Drejtoria e Repartit Inspektim Shpëtim Miniera	Titullar	II-b	I lartë	Inxh. miniere, ekonomist, jurist	1
B	Drejtoria e Inspektimit					17
		Zv. titullar, drejtor i drejtorisë së inspektimit	III-a	I lartë	Inxh. miniere	1
	Sektori i Kontrollit Teknik në Miniera	Përgjegjës i sektorit të kontrollit teknik në miniera	III-a/1	I lartë	Inxh. miniere	1
		Inspektor të kontrollit teknik në miniera, fabrika pasurimi dhe impiantet e përp. të mineraleve	III-b	I lartë	Inxh. miniere, gjeolog, gjeofizik	7
		Inspektor të kontrollit teknik të përdorimit civil të lëndës plasëse	III-b	I lartë	Inxh. miniere	2
		Inspektor të kontrollit teknik dhe matjes në miniera	III-b	I lartë	Inxh. markshejd	1
	Sektori i sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit	Përgjegjës sektori, inspektor ajrimi e monitorimi	III-a/1	I lartë	Inxh. miniere	1
		Inspektor i analizave dhe konfortit të punës	III-b	I lartë	Inxh. kimist	2
		Inspektor i transportit nëntokësor dhe impianteve energo-mekanike	III-b	I lartë	Inxh. mekanik Inxh. elektrik	2

	Drejt Emergj. dhe Shpëtimit në Miniera					16
C		Drejtori i emergjencave dhe shpëtimit në miniera	III-a	I lartë	Inxh. miniere	1
	Sektori i emergjencave dhe shpëtimit në miniera	Përgjegjës i sektorit të emergjencave dhe shpëtimit në miniera	III-a/1	I lartë	Inxh. miniere	1
		Teknik i mirëmbajtjes (kolaudit) të pajisjeve shpëtuese, shpëtues		I mesëm	Tek. energo-mekanik	2
		Përgjegjës i skuadrave të emergjencave dhe shpëtimit në miniera	III-b	I lartë	Inxh. miniere	2
		Teknik për emergjencën dhe shpëtimin (shpëtues)		I mesëm	Tek. miniere	10
D	Drejtoria Ekonomike e Shërbimit të Brend. dhe Informacionit					16
		Drejtori	III-a/1	I lartë	ekonomist	1
	Sektori ekonomik dhe shërbimeve të brendshme	Përgjegjës sektori	III-b	I lartë	ekonomist	1
		Magaznier		I mesëm	profesional/përgjithshëm	1
		Arkivist-protokollist, përpunues i dokumentacionit dhe sekretare e titullarit		I mesëm	profesional/përgjithshëm	1
		Shofer i titullarit		I mesëm	profesional/përgjithshëm	1

		Shofer i automjeteve të emergjencës		I mesëm	shofer	3
		Teknik i mirëmbajtjes dhe kolaudit të automjeteve		I mesëm	motorist	1
		Teknik i provave të litarëve të çelikut		I mesëm	mekanik	1
		Punonjëse sanitare		I mesëm	sanitare	1
	Sektori i burimeve njerëzore, komunikimit dhe ruajtjes së institucionit	Përgjegjës sektori	III-b	I lartë	jurist	1
		Teknikë të mesëm për komunikimin, informacionin dhe ruajtjen e institucionit		I mesëm	profesional përgjithshëm	4
	TOTALI					50

VENDIM
Nr.768, datë 15.7.2009

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE E TË RREGULLAVE PËR KANDIDIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË BRODIT MBIKËQYRËS TË AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE (AMSHC)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 8 të ligjit nr.10 093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e procedurave e të rregullave për kandidimin dhe përzgjedhjen e anëtarëve të bordit mbikëqyrës së Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**PROCEDURAT DHE RREGULLAT PËR KANDIDIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E
ANËTARËVE TË BORDIT MBIKËQYRËS TË ACJENCISË PËR MBËSHTETJEN E
SHOQËRISË CIVILE (AMSHC)**

**I. KRITERET E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE NGA ADMINISTRATA
PUBLIKE QENDRORE**

1. Kandidatët që përzgjidhen nga administrata publike qendrore nuk duhet të jenë pjesë e organeve drejtuese të organizatave të shoqërisë civile në kohën e përzgjedhjes, si dhe gjatë ushtrimit të mandatit të tyre si anëtarë të bordit mbikëqyrës të AMSHC-së.

2. Këta kandidatë nuk duhet të kenë qenë, gjatë 2 viteve të fundit, objekt i masave disiplinore për çështje administrative, me palë organizata të shoqërisë civile, palë të drejtpërdrejta në procedura administrative a gjyqësore kundrejt organizatave të shoqërisë civile dhe/ose objekt i ndonjë hetimi a procedure gjyqësore paraprake për vepra penale.

3. Vlerësohen me përparësi kandidatët që kanë ekspertizë në grantdhënie ose në zbatim projektsh.

II. KRITERET E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE NGA SHOQËRIA CIVILE

1. Kandidatët, që përzgjidhen si anëtarë të bordit mbikëqyrës të AMSHC-së, duhet të kenë jo më pak se 3 vjet përvojë pune me organizatat e shoqërisë civile.

2. Ata duhet të mos jenë të dënuar për vepra penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë, apo të mos jenë deklaruar përgjegjës për keqmenaxhimin e ndonjë personi juridik, me pasojë falimentimin e tij.

3. Vlerësohen me përparësi kandidatët, që kanë ekspertizë në grantdhënie ose në zbatim projektsh.

4. Secili kandidat duhet të mbështetet nga të paktën 5 organizata jofitimprurëse (OJF) ose organizata të shoqërisë civile, që punojnë në të njëjtën fushë ekspertize ose në fusha të ngjashme. Një OJF ose organizatë e shoqërisë civile mund të mbështesë vetëm një kandidat.

**III. PËRZGJEDHJA E PËRFAQËSUESVE TË SHOQËRISË CIVILE NË BORDIN
MBIKËQYRËS**

Nën përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, ndërmerren procedurat e mëposhtme:

a) Botohet njoftimi për hapjen e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve nga shoqëria civile, duke përdorur jo më pak se dy mjete të mundshme: median e shkruar, faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Ministrave, njoftimet e drejtpërdrejta nëpërmjet listave të kontakteve, faqet e internetit më të njohura në komunitetin e shoqërisë civile, listën e kontakteve me donatorët ose çdo mjet tjetër i mundshëm.

b) Njoftimi përmban kriteret e përzgjedhjes dhe cilësitë e kandidatëve, që mund të paraqiten nga shoqëria civile.

c) Organizatat e shoqërisë civile kanë 15 ditë punë afat nga data e njoftimit për të paraqitur kandidatët përkatës së bashku me dokumentet e nevojshme, përfshirë referencat, letrat mbështetëse nga 5 organizata jofitimprurëse dhe deklaratat sipas kreut II të këtij dokumenti.

ç) Brenda 5 ditëve punë nga përfundimi i afatit të mësipërm, Këshilli i Ministrave bën publike listën e kandidatëve të propozuar dhe që përmbushin kriteret për këtë qëllim.

d) Këshilli i Ministrave zgjedh 5 prej kandidatëve të propozuar dhe i emëron si anëtarë të bordit mbikëqyrës të AMSHC-së, duke mbajtur parasysh që të mos ketë dy anëtarë nga e njëjta fushë ose organizatë.

dh) Në caktimin e anëtarëve të bordit mbikëqyrës të AMSHC-së mbahet parasysh respektimi i parimeve të barazisë gjinore, sipas legjislacionit në fuqi.

**IV. PËRZGJEDHJA DHE EMËRIMI I PËRFAQËSUESVE TË SHOQËRISË CIVILE
NË BORDIN MBIKËQYRËS PAS PËRFUNDIMIT TË MANDATIT TË PARË**

1. Procedura e njoftimit dhe e propozimit të kandidatëve

a) Këshilli i Ministrave publikon njoftimin për hapjen e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve të shoqërisë civile për bordin mbikëqyrës të AMSHC-së, të paktën 3 muaj përpara

përfundimit të mandatit të tij, duke përdorur jo më pak se 3 nga mjetet e përmendura në shkronjën a” të kreut III të këtij dokumenti.

b) Njoftimi përmban kriteret e përzgjedhjes dhe cilësitë e kandidatëve, që mund të paraqiten nga shoqëria civile.

c) Organizatat e shoqërisë civile kanë 15 ditë pune afat nga data e njoftimit për të paraqitur kandidatët përkatës së bashku me dokumentet e nevojshme, përfshirë referencat, letrat mbështetëse nga 5 organizata jofitimprurëse dhe deklaratat sipas kreut II të këtij dokumenti.

ç) Brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i afatit të mësipërm, Këshilli i Ministrave bën publike listën e kandidatëve të propozuar dhe që përmbushin kriteret për këtë qëllim.

2. Mekanizmi i propozimit

a) Kanë të drejtë për të propozuar kandidatë OJF-të dhe organizata të tjera të shoqërisë civile të regjistruara sipas ligjit.

b) Secila OJF ka të drejtë të propozojë vetëm 1 përfaqësues në bordit mbikëqyrës të AMSHC-së.

c) Propozimi bëhet duke plotësuar një formular të veçantë, të nënshkruar dhe të vulosur me vulën zyrtare të organizatës propozuese. Formulari dërgohet me postë, faks apo i skanuar, si dhe me e-mail. Dërgimi i formularit të votimit me postë duhet të kryhet brenda afatit të caktuar për këtë qëllim në njoftimin e Këshillit të Ministrave.

3. Emërimi

Këshilli i Ministrave përzgjedh 5 kandidatë nga 15 kandidaturat, që kanë marrë më shumë propozime nga organizatat e shoqërisë civile, duke mbajtur parasysh që të mos ketë dy anëtarë nga e njëjta fushë ose organizatë dhe që të respektohet barazia gjinore, sipas legjislacionit në fuqi.

V. PËRFUNDIMI PARA KOHE I MANDATIT TË NJË ANËTARI BORDI


Nëse mandati i një anëtari të bordit mbikëqyrës të AMSHC-së, që përfaqëson shoqërinë civile, përfundon para afatit të parashikuar në ligj, Këshilli i Ministrave, brenda 30 ditëve, emëron, në vend të tij/saj, një përfaqësues të ri shoqërisë civile, duke e përzgjedhur atë nga lista e propozuar në fillim të mandatit të bordit mbikëqyrës ose fillon një procedurë të re përzgjedhjeje dhe emërimi, në përputhje me përcaktimet e kreut IV të këtij dokumenti.

SHËNIM

Sugjerohet që numri i punonjësve të AMSHC-së që propozohet për miratim të jetë: të paktën 12 (2 drejtori ekzekutiv dhe sekretari; 3 administratorë sipas sektorëve të cilët drejtojnë sektorin përkatës dhe janë përgjegjës edhe për një fushë të caktuar brenda tij; 7 specialistë sipas sektorëve si më poshtë:

- Drejtori ekzekutiv
- Sekretar i drejtorit ekzekutiv
- Administrimi i programeve të granteve dhe zhvillimit rajonal (3):
 - Grantet strategjike dhe zhvillimi rajonal (1 administrator)
 - Grantet e zhvillimit të shoqërisë civile (1 specialist)
 - Grantet e zhvillimit të filantropisë dhe të komunitetit (1 specialist)
- Zhvillimi i programeve, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe komunikimi (3):
 - Zhvillimi i projekteve dhe bashkëpunimi (1 Administrator)
 - Informimi dhe publikimi (1 specialist)
 - Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (1 specialist ICT)
- Financa dhe kontrolli i brendshëm (4):
 - Financa dhe kontrolli i brendshëm (1 administrator + 1 specialist)
 - Monitorimi financiar i granteve (1 specialist)
 - Shërbimet e administratës (1 specialist).

Lidhja 1: Struktura e administratës së AMSHC-së



VENDIM
Nr.769, datë 15.7.2009

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr.10 093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STATUTI I AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Të përgjithshme

Termi “Ligj” në këtë statut i referohet ligjit nr.10 093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

Neni 2
Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

1. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (në vijim AMSHC) organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit dhe të këtij statuti.

2. AMSHC-ja është krijuar për një afat të pakufizuar kohor.

3. Aktet e tjera të përgjithshme të AMSHC-së duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e ligjit, me legjislacionin në fuqi dhe këtë statut.

Neni 3
Selia

2. Selia e AMSHC-së ndodhet në Tiranë, në adresën

Neni 4
Stema dhe vula zyrtare

1. AMSHC-ja ka stemën dhe vulën e vet zyrtare.

2. Stema e AMSHC-së përbëhet nga Stema e Republikës së Shqipërisë dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

3. Vula e AMSHC-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr.390, datë 6.8.1993 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar dhe shënimin identifikues “Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Tiranë”.

4. Vula e AMSHC-së prodhohet, administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU II MISIONI DHE OBJEKTIVAT E AMSHC-SË

Neni 5 Misioni dhe objektivat e AMSHC-së

1. Misioni i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është nxitja, nëpërmjet asistencës financiare, e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimi i kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut, në përputhje me nenin 4 të ligjit, dhe me përparësitë e strategjitë e programit qeveritar, sipas fushave përkatëse.

2. Objektivat e AMSH-së janë:

a) Nxitja e bashkëpunimi me OJF-të, që kanë objekt të punës mbikëqyrjen e luftës kundër korrupsionit, luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore e të trajtimit të viktimave të saj, kundër dhunës në familje e kundër dhunës ndaj fëmijëve;

b) Nxitja e qytetarëve në veprimtari, përfshirja e pjesëmarrja e tyre për zhvillimin e komunitetit;

c) Krijimi e konsolidimi i aftësive të shoqërisë civile;

ç) Zhvillimi i bashkëpunimit ndërsektorial dhe i bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile;

d) Rritja e ndikimit publik dhe veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile;

dh) Zhvillimi i sipërmarrjes shoqërore dhe punësimit në sektorin jofitimprurës;

e) Rritja e ndikimit të shoqërisë civile në proceset e hartimit dhe të miratimit të politikave publike.

KREU III ORGANET E AMSHC-SË

Neni 6 Organet drejtuese

1. Drejtimi dhe administrimi i AMSHC-së kryhet nga:

a) bordi mbikëqyrës;

b) drejtori ekzekutiv.

2. Organet drejtuese të AMSHC-së ndihmohen dhe këshillohen nga Komisioni i Programeve dhe Komisioni Rajonal, si dhe organe të tjera, të përhershme ose të përkohshme, me natyrë ekzekutive, ndihmëse a këshilluese. Krijimi dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të tyre përcaktohen me vendim të bordit mbikëqyrës të AMSHC-së.

A. BORDI MBIKËQYRËS

Neni 7 Përbërja e bordit mbikëqyrës

Bordi mbikëqyrës i AMSHC-së përbëhet nga 9 anëtarë. Katër anëtarë të tij janë përfaqësues të institucioneve të administratës publike qendrore dhe 5 anëtarë përfaqësojnë organizatat e shoqërisë civile, sipas parimit të përfaqësimit të barabartë gjinor.

Neni 8

Mandati i anëtarit të bordit mbikëqyrës

1. Mandati i anëtarëve të bordit mbikëqyrës të AMSHC-së zgjat 4 vjet. Anëtarët e tij mund të rizgjidhen vetëm një herë.

2. Mandati i anëtarit të bordit mbikëqyrës mbaron përpara afatit në njërën nga rastet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 13 të ligjit.

3. Anëtari i bordit mbikëqyrës shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, në rastet kur vërehet se ka shkelur ligjin apo aktet e AMSHC-së, ka vepruar në kundërshtim dhe në shkelje të dispozitave për konfliktin e interesit, gjendet në kushtet e papajtueshmërisë me kriteret ligjore për këtë detyrë ose cenon reputacionin e AMSHC-së me sjelljet a qëndrimet e tij.

4. Procedura për emërimin e anëtarëve të rinj të bordit mbikëqyrës fillon të paktën 3 muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të bordit mbikëqyrës. Në rastet kur përfundimi i mandatit 4-vjeçar të bordit mbikëqyrës përkon me një periudhë zgjedhesh të përgjithshme parlamentare, bordi mbikëqyrës i kërkon Këshillit të Ministrave shtyrjen e mandatit të tij deri në krijimin e qeverisë së re.

Neni 9

Procedura për emërimin dhe zëvendësimin e anëtarëve të bordit mbikëqyrës

1. Përfaqësuesit nga organizatat e shoqërisë civile propozohen nga shoqëria civile dhe përzgjidhen sipas procedurave e rregullave të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të pikës 5 të nenit 8 të ligjit. Përfaqësuesit e institucioneve publike qendrore përzgjidhen nga Këshilli i Ministrave, nga institucionet që kanë më shumë ndërveprim me shoqërinë civile.

2. Në rastet kur mandati i një anëtari të bordit mbikëqyrës përfundon në mënyrë të parakohshme, kryetari i bordit mbikëqyrës vë në dijeni Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave brenda 7 ditëve nga përfundimi i parakohshëm i mandatit. Këshilli i Ministrave emëron një anëtar tjetër brenda 30 ditëve nga përfundimi i parakohshëm i mandatit. Mandati i anëtarit të ri vazhdon vetëm për kohën e mbetur të mandatit të anëtarit/es, që ai zëvendëson.

3. Në rast se zëvendësimi kryhet për një anëtar bordi mbikëqyrës, që është përfaqësues i shoqërisë civile, Këshilli i Ministrave mund të emërojë një përfaqësues tjetër nga shoqëria civile, që është kandiduar në procedurën e fundit për këtë qëllim, ose mund të nisë një procedurë të re kandidimi dhe shoqëria civile ftohet sërish për të dhënë kandidatura të reja.

Neni 10

Kompetencat e bordit mbikëqyrës

Bordi mbikëqyrës ka kompetencat e mëposhtme:

- a) Interpretin statutin e AMSHC-së dhe vendimet e tjera të përgjithshme, të marra prej tij;
- b) Miraton programin e veprimtarisë së AMSHC-së për vitin financiar, i cili paraqitet nga drejtori ekzekutiv i agjencisë;
- c) Miraton rregullat e hollësishme për kushtet dhe procedurat për shpërndarjen e fondeve, në përmbushje të misionit të AMSHC-së;
- ç) Vendosi për fondet e AMSHC-së, me të cilat financohen programet e kësaj agjencie ose miraton vendimet e organeve të tjera të AMSHC-së për përdorimin e fondeve të programeve;
- d) Shqyrton raportet e veprimtarisë së AMSHC-së dhe miraton planin e veprimeve, sipas fushave;
- dh) Miraton projektbuxhetin vjetor të AMSHC-së;
- e) Miraton rregullat e funksionimit të personelit të AMSHC-së dhe kriteret bazë të punësimit të tyre;
- ë) Vendosi për përdorimin e pasurisë së AMSHC-së;
- f) Zgjedh e shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin;

- g) Emëron e shkarkon nga detyra drejtorin ekzekutiv;
- gj) Miraton raportet e veprimtarisë së AMSHC-së, që i paraqiten Këshillit të Ministrave;
- h) Mbikëqyr në vazhdimësi përmbushjen e detyrave nga AMSHC-ja;
- i) Kryen detyra të tjera, në përputhje me dispozitat e ligjit dhe me këtë statut.

Neni 11

Mbledhjet e bordit mbikëqyrës

1. Bordi mbikëqyrës mbledhet jo më pak se katër herë në vit. Mbledhja është e vlefshme kur në të janë të pranishëm shumica e anëtarëve. Kur ky numër nuk arrihet, mbledhja shtyhet dhe mbahet brenda 24 orëve.

2. Mbledhja thirret dhe rendi i ditës propozohet nga kryetari i bordit mbikëqyrës ose të paktën 1/3 e anëtarëve.

3. Mbledhja e bordit mbikëqyrës njoftohet me shkrim nga kryetari i bordit mbikëqyrës, të paktën 10 ditë para datës së mbledhjes. Ftesa për mbledhje duhet të përmbajë datën, orën, vendin e zhvillimit të mbledhjes, rendin e ditës dhe materialet mbështetëse, të cilat dërgohen e merren nga anëtarët e bordit mbikëqyrës në formë të shkruar apo elektronike. Drejtori ekzekutiv ka të drejtë të propozojë çështje për t'u përfshirë në rendin e ditës së mbledhjeve të bordit mbikëqyrës.

4. Nëse mbledhja thirret duke shkelur rregullat e mësipërme, por të gjithë anëtarët janë të pranishëm dhe bien dakord ta pranojnë thirrjen e mbledhjes të vlefshme, atëherë ajo mund të vazhdojë rregullisht.

5. Mbledhjet drejtohen nga kryetari dhe, në rastet kur ky nuk është i pranishëm, nga zëvendëskryetari. Në rastet kur asnjëri prej tyre nuk është i pranishëm, mbledhja drejtohet nga anëtari më i moshuar, pjesëmarrës në mbledhje.

6. Vendimet merren nëpërmjet votimit të hapur. Zgjedhja ose shkarkimi i kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bordit mbikëqyrës dhe emërimi ose shkarkimi i drejtorit ekzekutiv të AMSHC-së kryhen me votim të fshehtë. Secili anëtar ka të drejtën e një vote. Votimi me përfaqësim nuk lejohet. Votimi mund të kryhet edhe me anë shkëmbimi të dokumentacionit të shkruar, sipas rregullave të konsultimit, me shkrim.

7. Në rastet kur numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit (apo drejtuesit të mbledhjes) është përcaktuese.

8. Vendimet për zgjedhjen ose shkarkimin e kryetarit të bordit mbikëqyrës, zëvendëskryetarit dhe drejtorit ekzekutiv, miratimin ose ndryshimin e këtij statuti, mënyrën e përdorimit të pasurive të paluajtshme, si dhe përfundimin e veprimtarisë së AMSHC-së merren me shumicën e thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të bordit mbikëqyrës. Vendimet e tjera merren me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Anëtarët e bordit mbikëqyrës nuk mund të abstenojnë në votim.

9. Gjatë mbledhjeve të bordit mbikëqyrës mbahet procesverbal. Kryetari autorizon një person të përhershëm për mbajtjen e tij.

10. Vendimet e bordit mbikëqyrës nënshkruhen nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga zëvendëskryetari dhe depozitohen në AMSHC.

11. Anëtarët e bordit mbikëqyrës nuk marrin pjesë në diskutimet dhe votimet, që lidhen me vetë ata, me të afërmit e tyre, si dhe me personat juridikë, ku ata apo të afërmit e tyre mund të kenë interesa private.

12. Në mbledhjet e bordit mbikëqyrës ftohen këshilltarë dhe/ose specialistë të jashtëm, kur këtë e kërkojnë rrethanat. Drejtori ekzekutiv, këshilltarët dhe specialistët e ftuar marrin pjesë në mbledhje pa të drejtë vote. Bordi mbikëqyrës mund të vendosë mospjesëmarrjen e drejtorit ekzekutiv në mbledhje, në rastet kur shqyrtohet statusi i tij i punësimit në AMSHC.

13. Mbledhjet e bordit mbikëqyrës janë të hapura për publikun. Rendi i ditës i mbledhjes, vendi, data dhe ora e mbledhjes shpallen në këndin e njoftimeve, në selinë e AMSHC-së dhe publikohen në faqen e saj të internetit. Bordi mbikëqyrës mund të vendosë që mbledhjet të bëhen të mbyllura, në rastet kur shqyrtohet ndonjë informacion konfidencial apo me natyrë personale.

Neni 12

Zgjedhja e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bordit mbikëqyrës

1. Bordi mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij kryetarin dhe zëvendëskryetarin. Ata zgjidhen në mbledhjen e parë të bordit të ri mbikëqyrës me shumicë të thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve.

2. Mandati i kryetarit dhe ai i zëvendëskryetarit të tij përfundojnë njëkohësisht me mandatin e bordit mbikëqyrës. Propozimi për përfundim të parakohshëm të mandatit mund të bëhet nga të paktën një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të bordit mbikëqyrës. Mandatet e kryetarit dhe zëvendëskryetarit përfundojnë, gjithashtu, me përfundimin e mandatit të tyre si anëtare të bordit mbikëqyrës.

3. Çdo anëtar i bordit mbikëqyrës i propozon Këshillit të Ministrave shkarkimin e anëtarëve të bordit mbikëqyrës, nëse pas dy mbledhjesh të vazhdueshme të bordit mbikëqyrës nuk është bërë e mundur zgjedhja e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bordit mbikëqyrës, sipas përcaktimeve të ligjit dhe të këtij statuti. Propozimi për shkarkim dërgohet brenda 8 ditëve nga mbledhja e fundit e bordit mbikëqyrës. Nëse afati i mësipërm përfundon, këtë të drejtë e ushtron, pa afat, drejtori ekzekutiv i AMSHC-së.

Neni 13

Kompetencat e kryetarit të bordit mbikëqyrës

Kryetari i bordit mbikëqyrës ka këto kompetenca:

- a) Thërret mbledhjet e bordit mbikëqyrës, propozon rendin e ditës dhe drejton mbledhjet e tij, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në këtë statut;
- b) Përfaqëson bordin mbikëqyrës në marrëdhënie me palë të treta;
- c) Mbikëqyr zbatimin e vendimeve të bordit mbikëqyrës dhe vë në dijeni atë për sa vë re;
- dh) Kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar nga ky statut ose të ngarkuar nga bordi mbikëqyrës.

Neni 14

Publikimi i vendimeve dhe procesverbaleve të bordit mbikëqyrës

Procesverbalet dhe vendimet e bordit mbikëqyrës, me përjashtim të pjesëve, që përmbajnë informacion konfidencial apo të dhëna personale, si dhe njoftimet e organeve të AMSHC-së publikohen në faqen e internetit të agjencisë, qoftë dhe në mënyrë të përmblendhur, si dhe në këndin e njoftimeve pranë selisë së AMSHC-së, brenda 10 ditëve nga data e mbajtjes ose marrjes së tyre.

Neni 15

Shpërblimi

Anëtarët e bordit mbikëqyrës përfitojnë shpërblim vetëm për pjesëmarrje në mbledhjet e tij, si dhe rimbursim të shpenzimeve për shërbime, udhëtime e dieta, që lidhen me veprimtarinë e tyre, për zbatimin e veprimtarive të AMSHC-së.

B. DREJTORI EKZEKUTIV

Neni 16

Drejtori ekzekutiv

1. Drejtori ekzekutiv i AMSHC-së emërohet dhe shkarkohet me vendim të bordit mbikëqyrës, të marrë me shumicën e thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të tij. Anëtarët e bordit mbikëqyrës, në ushtrim të mandatit, dhe/ose personat fizikë ose drejtues të personave juridikë debitorë të AMSHC-së, si dhe të afërmit e tyre, në vijë të drejtë ose të tërthortë, deri në shkallë të tretë, nuk mund të emërohen në pozicionin e drejtorit ekzekutiv.

2. Përzgjedhja e drejtorit ekzekutiv bëhet nga të paktën tre konkurrues.
3. Drejtori ekzekutiv bën përpjekjet e nevojshme dhe kujdeset që veprimtaria e bordit mbikëqyrës të zhvillohet në kushte sa më optimale, duke ofruar të gjithë informacionin e bazën materiale të nevojshme.
4. Drejtori ekzekutiv shkarkohet nga detyra kur:
 - a) shkel ligjin apo aktet e AMSHC-së;
 - b) ka konflikt interesash me AMSHC-në;
 - c) cenon, me sjelljet a qëndrimin e tij, reputacionin e AMSHC-së;
 - ç) arrihet në përfundim se është i paaftë, me dy vlerësime negative të njëpasnjëshme të punës.
5. Vendimi për shkarkimin e drejtorit ekzekutiv merret nga bordi mbikëqyrës me shumicën e thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të tij, me propozimin e një së tretës së tyre.
6. Drejtori i ri ekzekutiv emërohet jo më vonë se 30 ditë nga data kur pozicioni mbetet vakant.

Neni 17

Kompetencat e drejtorit ekzekutiv

1. Drejtori ekzekutiv ka këto kompetenca:
 - a) Vepron në emër të AMSHC-së në marrëdhëniet me palë të treta dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së AMSHC-së;
 - b) Drejton, administron e mbikëqyr veprimtarinë e AMSHC-së dhe personelit të saj, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, statutin e AMSHC-së dhe rregullat e miratuara nga bordi mbikëqyrës;
 - c) Organizon e bashkërendon punën ndërmjet njësive të AMSHC-së;
 - ç) Harton rregulloren e brendshme të veprimtarisë së AMSHC-së dhe ia paraqet për miratim bordit mbikëqyrës;
 - d) Nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshme të detyrueshme për menaxhimin administrativ dhe financiar të institucionit;
 - dh) I bën propozime dhe sugjerime bordit mbikëqyrës, në të mirë dhe interes të veprimtarisë së AMSHC-së, sa herë që i kërkohet ose me nismën e vet, përfshirë planin financiar të veprimtarisë e shpenzimet financiare dhe siguron zbatimin e vendimeve të tij;
 - e) I paraqet çdo vit bordit mbikëqyrës raportin e veprimtarisë së AMSHC-së me shpenzimet dhe të ardhurat financiare, si dhe projektbudgetin e AMSHC-së për vitin në vazhdim;
 - ë) Lidh kontrata në emër të AMSHC-së;
 - f) Siguron bashkëpunimin me institucionet publike dhe personat juridikë vendas apo të huaj në të mirë dhe interes të veprimtarisë së AMSHC-së;
 - g) Ushtron çdo detyrë që nuk i është dhënë bordit mbikëqyrës apo ndonjë organi tjetër të AMSHC-së sipas ligjit, legjislacionit në fuqi dhe këtij statuti.
2. Shpenzimet dhe të ardhurat financiare të përmendura në shkronjën “e” të pikës së mësipërme, përfshijnë bilancin, llogaritë e të ardhurave e të shpenzimeve dhe evidencat e tjera përkatëse. Raporti vjetor dhe programi i veprimtarisë së ardhshme financiare miratohen nga bordi mbikëqyrës i AMSHC-së dhe i paraqiten, çdo vit, nëpërmjet Ministrit të Financave, Këshillit të Ministrave.
3. Drejtori ekzekutiv i AMSHC-së mund të nënshkruajë në emër e për llogari të AMSHC-së transaksione me vlerë më të madhe se pesë milionë lekë pas miratimit paraprak, me shkrim të bordit mbikëqyrës. Në rastet kur bordi mbikëqyrës nuk mund të mblidhet në kohë, miratimi me shkrim mund të jepet nga kryetari i tij, dhe në pamundësi të tij, nga zëvendëskryetari i bordit mbikëqyrës. Në këto raste, bordi mbikëqyrës duhet të shprehet për transaksione të kryera në mbledhjen e tij me të afërt të ardhshme.

Neni 18

Administrata dhe struktura e personelit të AMSHC-së

1. Administrata e AMSHC-së drejtohet nga drejtori ekzekutiv. Organizimi e funksionimi i personelit të AMSHC-së rregullohen sipas rregullores së brendshme të AMSHC-së, që miratohet nga bordi mbikëqyrës.

2. Struktura e punonjësve të administratës së AMSHC-së është sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij statuti.

3. Kriteret e marrjes në punë të personelit të AMSHC-së, si dhe përshkrimi i vendeve të punës miratohen nga bordi mbikëqyrës me propozim të drejtorit ekzekutiv dhe lidhja e kontratave të punës bëhet nga drejtori ekzekutiv.

4. Nëpunësit e AMSHC-së, me përjashtim të punonjësve mbështetës, kanë arsimin e lartë.

5. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AMSHC-së rregullohen sipas Kodit të Punës.

6. Largimi nga puna bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në Kodin e Punës, si dhe kur dënohet me një vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Neni 19

1. Anëtarët e organeve dhe nëpunësit e AMSHC-së i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në përputhje me dispozitat e ligjit, legjislacionin në fuqi, këtë statut dhe aktet e tjera të përgjithshme të AMSHC-së.

2. Dispozitat e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare për sekretin e veprimtarisë tregtare janë të zbatueshme për të gjithë anëtarët e organeve dhe nëpunësit e AMSHC-së.

Neni 20

Konflikti i interesit

1. Anëtari i bordit mbikëqyrës ose i çdo organi tjetër të AMSHC-së, përfshirë personelin e saj, nuk mund të votojë ose të marrë pjesë në vendimmarrje kur ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe nenit 14 të ligjit.

2. Anëtari i bordit mbikëqyrës ose i çdo organi tjetër të AMSHC-së janë të detyruar të deklarojnë konfliktin e interesit te kryetari i organit të cilit i përkasin të paktën para pjesëmarrjes në vendimmarrje ose votimit. Drejtori ekzekutiv e bën deklarinimin pranë bordit mbikëqyrës.

3. Personeli i AMSHC-së është i detyruar të bëjë deklarinimin me shkrim të konfliktit të interesave të tyre dhe/ose të të afërmeve të tyre me interesat e AMSHC-së. Kjo deklaratë i dorëzohet drejtorit ekzekutiv, i cili merr masa që konflikti i interesave të parandalohet ose të shmanget. Nëse ka ndonjë ndryshim të situatës njoftohet përsëri jo më vonë se 15 ditë kalendarike pasi ka ndodhur ndryshimi.

4. Anëtarët e bordit mbikëqyrës njoftojnë lidhur me raste të konfliktit të interesave në mbledhjen më të parë të tij. Ata nuk mund të marrin pjesë në diskutime dhe vendime që kanë të bëjnë me persona apo organe me të cilat mund të ndodhen në konflikt interesi sipas legjislacionit në fuqi.

5. Transaksionet me palë të treta ku një anëtar i bordit mbikëqyrës apo drejtori ekzekutiv kanë interes privat mund të lejohen vetëm në rastet kur transaksioni ofron kushtet më të favorshme për AMSHC-në, gjë e cila duhet dokumentuar dhe miratuar nga bordi mbikëqyrës me vendim.

6. Në rastet kur ekziston një konflikt interesi që pengon veprimtarinë normale të AMSHC-së apo krijon problem për të, drejtori ekzekutiv mund t'i kërkojë anëtarit përkatës të personelit të AMSHC-së ta zgjidhë këtë konflikt brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Në rast se konflikti nuk zgjidhet, drejtori ekzekutiv ka të drejtë të marrë masa për shmangien e konfliktit. Në rastet kur në këtë situatë ndodhet një anëtar i bordit mbikëqyrës, apo drejtori ekzekutiv, atëherë këtë kompetencë e ka bordi mbikëqyrës.

Neni 21

Ankimi ndaj vendimeve të organeve drejtuese të AMSHC-së

1. Vendimet e bordit mbikëqyrës, të drejtorit ekzekutiv ose të organeve të tjera të AMSHC-së mund të ankimohen pranë bordit mbikëqyrës brenda një muaji nga marrja dijeni për to. Kundër vendimeve të bordit mbikëqyrës mund të bëhet ankimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Pas shqyrtimit të ankimit, në përputhje me procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, bordi mbikëqyrës merr vendim jo më vonë se tre muaj pas paraqitjes së ankimit dhe vë në dispozicion të ankuesit dy kopje origjinale të vendimit të tij.

KREU IV

BURIMET E FINANCIMIT TË AMSHC-SË DHE RREGULLAT PËR PËRDORIMIN E TYRE

Neni 22

Burimet e financimit dhe përdorimi i tyre

1. AMSHC-ja mban llogaritë, që lidhen me fondet e saj, në sistemin e thesarit dhe i përdor ato në përputhje me legjislacionin në fuqi. Fondet e përfituara në monedhë të huaj depozitohen në llogari të veçanta bankare, në banka me seli në Republikën e Shqipërisë dhe administrohen sipas rregullave të sistemit të thesarit.

2. Krahas financimit nga Buxheti i Shtetit, AMSHC-ja mund të sigurojë të ardhura të veta nëpërmjet veprimtarive të ligjshme që ushtron ose pasurive që administron, si dhe të ardhura të tjera që parashikohen me ligj. AMSHC-ja mund të realizojë të ardhura nga administrimi i pronave të paluajtshme dhe pasurive të tjera të saj, për sa kohë që kjo veprimtari nuk pengon realizimin e objektivave dhe ushtrimin e përgjegjësisë për të cilat është krijuar.

3. AMSHC-ja mund të pranojë dhurime në vlerë, mallra ose shërbime në përputhje me legjislacionin në fuqi me kusht që dhurimi i tyre të mos cenojë apo pengojë ushtrimin e ligjshëm të misionit e veprimtarisë së saj ose të vijë ndesh me qëllimet e saj. Bordi mbikëqyrës mund të refuzojë një dhurim në rastet kur kushtet që e shoqërojnë atë bien në kundërshtim me qëllimet e AMSHC-së. Në çdo rast, pranimi i tyre dokumentohet dhe administrohet, sipas rastit, në përputhje me rregullat e marrëveshjes së nënshkruar me dhuruesin.

4. Në rastet kur dhurimi nuk është në të holla, bordi mbikëqyrës mund të vendosë, sipas rastit, që malli i dhuruar të kthehet në të holla ose të përcaktojë mënyrën e administrimit të tij në formën që është.

5. Fondet që AMSHC-ja siguron nga burime të ndryshme përdoren vetëm për kryerjen e veprimtarive sipas misionit të saj.

6. AMSHC-ja mund të organizojë konkurse për grantdhënie, në emër të institucioneve të tjera publike ose donatorëve të tjerë, objektivat e të cilave përputhen me ato të AMSH-së. Ajo i kryen këto shërbime për llogari të të tretëve kundrejt pagesës.

7. AMSHC-ja nuk mund të marrë hua dhe nuk mund të jetë përgjegjëse për huatë e marra nga anëtarë të bordit të saj mbikëqyrës, drejtori ekzekutiv, personeli apo palë të treta.

Neni 23

Ndalimet për ndarjen e fitimit

AMSHC-ja nuk mund të ndajë fitimin apo çdo diferencë tjetër pozitive, mes të ardhurave dhe shpenzimeve, te anëtarët e bordit mbikëqyrës, apo personeli i Agjencisë, si dhe te të afërmit e tyre apo persona juridikë të cilët kontrollojnë apo janë pjesëmarrës në menaxhim.

KREU V
RAPORTIMI FINANCIAR DHE AUDITIMI

Neni 24
Raportimi financiar dhe auditimi

Veprimtaria financiare e AMSHC-së auditohet sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25
Mbyllja e veprimtarisë

Bordi mbikëqyrës i propozon Këshillit të Ministrave mënyrën si do të përdoren pasuritë e mbetura pas mbylljes së veprimtarisë së AMSHC-së.

Neni 26
Rregulla specifike


Çështje specifike të veprimtarisë së AMSHC-së, të cilat nuk parashikohen në ligj dhe në këtë statut rregullohen në rregulloren e brendshme të AMSHC-së.

SHËNIM

Sugjerohet që numri i punonjësve të AMSH-së që propozohet për miratim të jetë: gjithsej të paktën 12 (2: drejtori ekzekutiv dhe sekretari; 3 administratorë sipas sektorëve të cilët drejtojnë sektorin përkatës dhe janë përgjegjës edhe për një fushë të caktuar brenda tij; 7 specialistë sipas sektorëve si më poshtë:

- Drejtori ekzekutiv
- Sekretar i drejtorit ekzekutiv
- Administrimi i programeve të granteve dhe zhvillimit rajonal (3):
 - Grantet strategjike dhe zhvillimi rajonal (1 administrator)
 - Grantet e zhvillimit të shoqërisë civile (1 specialist)
 - Grantet e zhvillimit të filantropisë dhe të komunitetit (1 specialist)
- Zhvillimi i programeve, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe komunikimi (3):
 - Zhvillimi i projekteve dhe bashkëpunimi (1 administrator)
 - Informimi dhe publikimi (1 specialist)
 - Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (1 specialist ICT)
- Financa dhe kontrolli i brendshëm (4):
 - Financa dhe kontrolli i brendshëm (1 administrator + 1 specialist)
 - Monitorimi financiar i granteve (1 specialist)
 - Shërbimet e administratës (1 specialist).

Lidija I: Struktura administratės AMSHC-sė



VENDIM
Nr.770, datë 15.7.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRAVE, TË FORMAVE, KRITEREVE DHE TË
RREGULLAVE SHITESË, PËR ORGANIZIMIN E LOJËRAVE TË FATIT,
PROMOCIONALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. FORMAT DHE RREGULLAT PËR ORGANIZIMIN E LOJËRAVE TË FATIT,
PROMOCIONALE**

1. Lojërat e fatit, promocionale, mund të organizohen nga subjekte, publike ose private, që dëshirojnë të promovojnë produkte apo shërbime të biznesit/veprimtarisë së tyre, duke i ofruar fituesit të lojës një çmim/premio të caktuar, në mjete monetare ose në ndonjë formë tjetër shpërblimi.

2. Pjesëmarrësit (lojtarët në lojë) mund të marrin pjesë në to, duke parapaguar një shumë të caktuar në mjete monetare ose në ndonjë formë tjetër pagese, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë.

3. Lojërat e fatit, promocionale, mund të organizohen nga organizatorët edhe duke e ofruar:

a) falas produktin/shërbimin, që do të promovohet;

b) produktin/shërbimin me çmimin e shitjes dhe bashkë me produktin mund të ofrohet edhe:

i) një kupon;

ii) një biletë;

iii) mundësia për të gërvishur në ambalazhin e produktit të blerë;

iv) çdo mënyrë tjetër, e parashikuar nga organizatori, por pa kosto të tjera shtesë për klientin.

Pas përfundimit të lojës, promovuesi ofron dhe shpall fituesit, të cilët shpërblehen me produkte ose shërbime.

4. Subjekteve, të cilat kanë objekt të veprimtarisë së tyre lojërat e fatit, nuk u lejohet të organizojnë lojëra fati, promocionale.

5. Subjektet, publike apo private, mund të organizojnë lojë fati, promocionale, vetëm pasi të jenë pajisur me autorizimin përkatës nga Ministri i Financave.

6. Për lojërat e fatit, promocionale, jepet autorizimi i posaçëm, sipas formatit të përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Autorizimi është i vlefshëm nga data e fillimit të lojës (e cila nuk duhet të fillojë më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes së autorizimit) dhe vlen vetëm për një tip (lloj) të caktuar loje promocionale.

7. Kohëzgjatja e lojës promocionale përcaktohet me autorizim, bazuar në kërkesën e organizatorit të lojës dhe në gjykimin objektiv të autoritetit, që merr në shqyrtim dokumentacionin, në varësi të llojit dhe formës së lojës, që do të organizohet.

8. Për marrjen e autorizimit, subjekti duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Financave dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën me shkrim, ku të evidentohen të dhënat e subjektit, objekti i veprimtarisë së tij, drejtoria rajonale tatimore, ku subjekti është i regjistruar, dhe një përshkrim i shkurtër i lojës, që do të organizohet;

b) Ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;

c) Deklaratën (vërtetim) nga organi tatimor për detyrime të pashlyera;

ç) Rregulloren dhe mënyrën e organizimit të lojës promocionale, me hollësi dhe sipas kriterëve, që duhet të përmbushë organizatori, siç parashikohet në pikën 14 të këtij vendimi.

Mosplotësimi i njërës prej kërkesave të mësipërme përbën arsye për refuzimin e kërkesës dhe dhënien e autorizimit.

9. Kur subjekti përmbush kushtet për marrjen e autorizimit, pas miratimit nga Ministri i Financave, një kopje e tij i jepet subjektit, një kopje i përcillet njësisë së mbikëqyrjes së lojërave të fatit (NJMLF) dhe një kopje drejtorisë rajonale tatimore, ku është i regjistruar.

10. Autorizimi lëshohet brenda 20 ditëve pune, nga data e paraqitjes së kërkesës së subjektit në protokollin e Ministrisë së Financave.

11. Subjekteve, të cilat nuk përmbushin kushtet për marrjen e autorizimit, u refuzohet kërkesa, duke evidentuar edhe arsyet e refuzimit.

II. MËNYRA DHE KRITERET E ORGANIZIMIT TË LOJËRAVE TË FATIT, PROMOCIONALE

1. Mënyra e organizimit të lojës promociionale përcaktohet dhe deklarohet nga organizatori i lojës.

2. Kriteret, që duhet të plotësojë pjesëmarrësi në lojë, përcaktohen dhe deklarohen nga organizatori i lojës përpara organizimit të saj dhe evidentohen në rregulloren e lojës.

3. Rregullorja e lojës duhet të përmbajë, krahas të dhënave të tjera, edhe këto të dhëna të detyrueshme:

a) Llojin (tipin) e lojës promociionale, që do të organizohet;

b) Afatin (kohëzgjatjen) e lojës, sipas parashikimit të organizatorit;

c) Numrin (sasinë) e shpërblimeve dhe mënyrën e shpërblimit të fituesve;

ç) Vlerën monetare (çmimin), me dhe pa TVSH, që duhet të paguajë pjesëmarrësi në lojë, apo format e tjera të pagesës, në varësi të mënyrës së organizimit të lojës, në përputhje me shkronjat “a” e “b” të pikës 3 të këtij vendimi.

d) Çmimin (premin), që do të japë organizatori i lojës, të konvertuar edhe në vlerë monetare;

dh) Numrin e parashikuar të pjesëmarrësve në lojë.

4. Pjesëmarrësit në lojë duhet të jenë persona të identifikueshëm (të paktën në çastin e marrjes së çmimit) nga organizatori i lojës.

5. Për tipet e lojërave promociionale, të përcaktuara më poshtë, organizatori duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme, sipas llojit të lojës:

a) Për lojën promociionale me anë të mesazheve (sms), duhet të deklarojë, jo vetëm për pjesëmarrësit në lojë, por edhe në rregulloren e lojës:

i) koston e një mesazhi telefonik, me ose pa TVSH, e cila nuk mund të kalojë vlerën 100 (njëqind) lekë me TVSH;

ii) numrin, ku duhet të dërgohet mesazhi;

iii) operatorin, që do të ofrojë shërbimin;

b) Për lojën promociionale me telefonata, duhet të deklarojë jo vetëm për pjesëmarrësit në lojë, por edhe në rregulloren e lojës:

i) koston e një telefonate, me ose pa TVSH, e cila nuk mund të jetë më e lartë se 200 (dyqind) lekë/telefonatë, pa TVSH;

ii) numrin, ku duhet të dërgohet;

iii) operatorin, që ofron shërbimin.

6. Fituesit e çmimeve të ofruara përzgjidhen sipas mënyrës/ave, që detyrimisht përmbajnë elementin rastësor.

7. Për marrjen e autorizimit, subjekti duhet të derdhë, përpara marrjes së autorizimit, për llogari të Ministrisë së Financave, shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë/autorizim. Në rast refuzimi të autorizimit, shuma e paguar është e kthyeshme nga autoriteti, pranë të cilit është arkëtuar shuma, brenda 20 ditësh nga data e refuzimit të autorizimit.

8. Çmimi (premio) i ofruar nga organizatori i lojës së fatit, i konvertuar në vlerë monetare, nuk duhet të jetë më i vogël se 80 për qind e shumës së akumuluar prej pjesëmarrësve në lojë, për lojërat e organizuara nëpërmjet mesazheve (sms) apo të telefonatave.

9. Për tipet e tjera të lojërave, organizatori duhet të deklarojë në rregulloren e lojës së fatit çmimin, që do të ofrojë, të konvertuar edhe në vlerë monetare.

10. Tërheqja e çmimit duhet të bëhet e mundur në kohën, vendin dhe mënyrën e publikuar nga organizatori. Në çastin e ndarjes së çmimeve duhet të asistojnë edhe një përfaqësues nga NJMLF-ja dhe një përfaqësues nga drejtoria rajonale tatimore, ku subjekti është i regjistruar, të cilët mbajnë procesverbalin përkatës. Procesverbali i ndarjes së çmimit depozitohet në drejtorinë rajonale tatimore, ku subjekti është i regjistruar.

11. Subjekti duhet që, 20 ditë përpara ditës së ndarjes së çmimeve të depozitojë një kërkesë te drejtoria rajonale tatimore dhe Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, për njoftimin e datës dhe të orës së ndarjes së çmimeve.

12. Titullarët e organeve përkatëse pajisin me autorizim personat e caktuar prej tyre, për të asistuar në ndarjen e çmimeve. Mosparaqitja e tyre, në rastin kur është depozituar kërkesa nga subjekti organizues i lojës, i ngarkon me përgjegjësi administrative.

13. Në rast se organizatori e kryen ndarjen e çmimeve pa njoftuar drejtorinë përkatëse, subjektit i hiqet e drejta për autorizim, për një periudhë 3-vjeçare, pas përfundimit të afatit të autorizimit të lëshuar, dhe organet tatimore kryejnë rivlerësimin e situatës së tij financiare, sipas ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

14. Organizatori i lojës duhet të mbajë, për një periudhë jo më pak se 6 vjet, të gjithë dokumentacionin për lojën promocionale të fatit (mënyrën e zhvillimit, numrin e pjesëmarrësve, çmimet e shpërndara, emrat dhe adresat e fituesve etj.).

15. Ministri i Financave, me udhëzim, përcakton hollësisht procedurat, që duhet të ndjekë autoriteti, i cili do të merret me shqyrtimin e dokumentacionit të subjekteve, aplikues e për autorizim, si dhe mënyrën e kontrollit, që do të ushtrohet nga organet tatimore dhe Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, në zbatim të dispozitave të këtij vendimi.

16. Ngarkohen Ministria e Financave, NJMLF-ja, strukturat e kontrollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe drejtoria rajonale tatimore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.772, datë 15.7.2009

**PËR DHËNIE FONDI NDIHME PARTISË “ALEANCA PËR DEMOKRACI DHE
SOLIDARITET”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580 datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Partisë “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet” t’i jepet një fond prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, për vitin 2009.

3. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.774, datë 17.7.2009

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË GJASHTË AUTOMJETEVE DHE
TETËMBËDHJETË TRUPAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 19 korrik 2009, të 3 (tri) automjeteve dhe 9 (nëntë) trupave ushtarake italiane.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 21 korrik 2009, të 2 (dy) automjeteve dhe 6 (gjashtë) trupave ushtarake italiane.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 24 korrik 2009, të 1 (një) automjeti dhe 3 (tri) trupave ushtarake italiane.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për automjetet dhe trupat ushtarake italiane, që do të kalojë në datën 19 korrik 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për automjetet dhe trupat ushtarake italiane, që do të kalojë në datat 21 e 24 korrik 2009, është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Automjetet dhe trupat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.775, datë 8.7.2009

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOO”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRIËS DHE TË ENERGJETIKËS, MINISTRISË SË RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE TË TURIZMIT, MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT DHE “HIDROINVEST” SHPK-SË, ÇARSHOVË, PËRMET, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE NË STRANIK DHE ZALL TORE, NË KOMUNËN STRAVAJ, LIBRAZHD”, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.565, DATË 12.8.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në marrëveshjen e koncesionit, të formës “BOO”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe “Hidroinvest” sh.p.k.-së, Çarshovë, Përmët, për ndërtimin e hidrocentraleve në Stranik dhe Zall Tore, në komunën Stravaj, Librazhd, të miratuar me vendimin nr.565, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Kudo në vendimin nr.565, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave dhe në tekstin e marrëveshjes së koncesionit, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, emërtimet “Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit” zëvendësohen me “Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARREVESHJE

PER

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE MARREVESHJEN E KONCESIONIT TE FORMES "BOO" TE LIDHUR NDERMJET MINISTRISE SE INDUSTRISE DHE TE ENERGJETIKES, MINISTRISE SE RREGULLIMIT TE TERRITORIT DHE TE TURIZMIT, MINISTRISE SE BUJQESISE, DHE TE USHQIMIT DHE SHOQERISE "HIDROINVEST" SHPK, ÇARSHOVE PERMET, PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALEVE NE STRANIK DHE ZALL TORE, NE KOMUNEN STRAVAJ, LIBRAZHË, TE MIRATUAR ME VENDIMIN NR.565, DATE 12.08.2005, TE KESHILLIT TE MINISTRAVE.

Ne Tirane, sot me date 27 korrik 2009, palët:

O.S.H.A, e perfagesuar, perkatesisht, nga Titullarët, z. Genc RULI i datëlindjes 11.06.1958, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr. 110000374; z. Jemin Gjana i datëlindjes 15.08.1955 madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr. 110000829;

dhe

Shoqeria "Hidroinvest" Shpk, regjistruar si person juridik ne Gjykate me Vendim nr.32445, date 22.11.2004, qe me poshte do te quhet "Koncesionari", perfagesuar nga administratori Z. Bardhyl Hazizaj, i biri i Dines, i datelindjes 15.08.1955, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, Rruga "Sami Frasheri" Nr.20/3, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta Nr. Z1248575, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,

me vullnetin e tyre te lire, bien dakord si me poshte:

Te lidhin kete marreveshje, si pjese perberese e marreveshjes se koncesionit te formes "BOO", te miratuar me VKM nr.565, date 12.08.2005 " Per miratimin e Marreveshjes se koncesionit te formes "BOO", ndermjet Ministrise se Industrise dhe Energjetikes, Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe te Turizmit, Ministrise se Bujqesise dhe te Ushqimit dhe Shoqerise "Hidroinvest"shpk, Çarshove Permet, per ndertimin e hidrocentraleve ne Stranik dhe Zall Tore, ne Komunen Stravaj, Librazhd".

Hyrje

Duke pasur parasysh qe:

- Shoqërise “Hidroinvest” shpk (Koncesionari), gjatë hartimit të projektzbatimit të objektit të miratuar me VKM nr.565, datë 12.08.2005, i rezultuan zgjidhje me të leverdisshme tekniko-ekonomike për ndërtimin e HEC-ve “Zall Tore” dhe Stranik”;
- Forma e koncesionit nuk ndryshon, treguesit kryesore teknike, si fuqia dhe prodhimi vjetor rriten, duke e bërë këtë projekt me të leverdisshëm;
- O.S.H.A, bazuar në projektin e ri është e interesuar për zbatimin e tij, sepse përfitimi është më i lartë për vendin;
- Duke marrë në konsideratë të gjitha pengesat e hasura nga koncesionari gjatë implementimit të marrëveshjes ekzistuese të koncesionit, të cilat çuan në mosrealizim në kohë të investimeve të parashikuara në kontratë;
- Në Marrëveshjen ekzistuese të Koncesionit ka mangësi për të realizuar monitorimin e duhur të ecurisë së objektit të koncesionit, bëhet e domosdoshme ndërhyrja në disa nënë të marrëveshjes.

Palet bien dakord që në marrëveshjen baze të miratuar me VKM nr.565, datë 12.08.2005, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, “Përkufizime”:

- Tek paragrafi i parë, pikë 2 „**Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA)**”, fjalët „Ministria e Industrisë dhe Energjetikës, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit“, **zëvendësohen me fjalët:** „Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit“.

Neni 2

Përmbajtja e nenit 3, “Karakteristikat e Hidrocentraleve”, zëvendësohet me:

Hidrocentralet “Stranik” dhe “Zall Tore” do të ndërtohen në rrjedhën e Lumit “Radiçinë”, në Rrethin e Librazhdit, me këto karakteristika:

- **Hidrocentrali "Stranik "**
- Kuotat e veprave
- o Kuota e vepres se marrjes 690 m
- o Kuota e godines se centralit 534 m
 - Fuqia e Instaluar 4,600 kW
 - Prodhimi vjetor i energjisë elektrike 19,000,000 kWh
- **Hidrocentrali "Zall Tore"**
- Kuotat e veprave
- o Kuota e vepres se marrjes 532 m
- o Kuota e godines se centralit 452 m
 - Fuqia e Instaluar 3,000 kW
 - Prodhimi vjetor i energjisë elektrike 12,500,000 kWh

Neni 3

Permbajtja e nenit 6, "Vleresimi i investimeve", ndryshon si me poshte:
 "Mbi bazen e te dhenave te projektit, investimet qe duhet te kryen nga koncesionari per hidrocentralet "Zall Tore" dhe "Stranik" jane ne vleren totale, jo me pak se 1,056,529,888(njemiliard e pesedhjetegjashtemilion e peseqindenzetenentemije e teteqindetetedhjetetete) leke, te ndara sipas aneksit 1 bashkelidhur kesaj marreveshjeje.

Neni 4

Ne nenin 9 "Programi i punimeve":

Ne piken 3 fjalet "...brenda 30 (tridhjetë) muajve nga hyrja ne fuqi e kontrates", **zevendesohen** me "...brenda 12 (dymbedhjetë) muajve nga hyrja ne fuqi e kesaj marreveshjeje".

Neni 5

Ne nenin 11 "Zgjidhja e Marreveshjes se Koncesionit", tek paragrafi i dyte, fjalet: "...te permendura ne nenin 8 te kesaj marreveshjeje...", **zevendesohen** me "...te permendura ne nenin 4 te kesaj marreveshjeje..."

Neni 6

Ne nenin 18, "Hyrja ne fuqi e marreveshjes se koncesionit", fjalet "...ne perputhje me ligjin nr.7973, date 26.07.1995 "Per koncesionet dhe pjesemarrjen e sektorit privat ne sherbimet dhe infrastrukturen publike", **zevendesohen** me "...ne perputhje me ligjin nr.9663, date 18.12.2006 "Per koncesionet".

Neni 7

Ne nenin 11, "Sanksionet",:

- paragrafi i dytë ndryshon si më poshtë:
 - Në rast shkeljeje të afatit të përcaktuar në nenin 4 të kësaj marrëveshjeje, koncesionari do t'i paguaje OSHA-se për çdo ditë vonese penaltetin 0,01% të vlerës së investimit.
- pas paragrafit të dytë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
 - “Në rast mosrealizimi të programit të prodhimit, të përcaktuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje, koncesionari penalizohet me 0,01 % të vlerës së prodhimit të përcaktuar për periudhën raportuese”.

Neni 8

Ndryshimet dhe shtesat e përcaktuara në këtë marrëveshje hyjnë në fuqi me nënshkrimin e saj nga paletë dhe pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Nenet e tjera të kontratës baze nuk kanë ndryshuar.

Marrëveshja hartohet në 7 (shtatë) kopje dhe nënshkruhet pa vërejtje nga të dy paletët.

Per Organin Shtetëror të Autorizuar



Per Koncesionarin

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjetikës

Shoqëria “Hidroinvest” Shpk


Perfaqësuar nga :

z. GENC RULI

Perfaqësuar nga :

z. Bardhyl Hazizaj




Ministria e Bujqësisë, Ushqimit
dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Perfaqësuar nga :

z. JEMIN GJANA




PREVENTIVI PERMBLEDHES

Nr.	EMERTIMI	NJESIA	HC STRANIK	HC ZALL TORE
1	VEPRA E MARRJES	LEKE	7400000	27800000
2	KANALI I SJELLJES	LEKE	125100000	193300000
3	DEKANTUESI	LEKE	9120000	16800000
4	TUNELET	LEKE	10200000	
5	SIFONI	LEKE		13500000
6	BASENI ME PRESION	LEKE	14200000	14250000
7	TUBACIONI I TURBINAVE	LEKE	37300000	16800000
8	NDERTESA E CENTRALIT	LEKE	67100000	44570000
	SHUMA	LEKE	270420000	327020000
9	OBJEKTE PROVIZORE 2%	LEKE	5408400	6540400
	SHUMA	LEKE	275828400	333560400
10	FOND REZERVE 6 %	LEKE	16549704	20013624
	SHUMA	Leke	292378104	353574024
	TVSH 20%	LEKE	55165680	66712080
	SHUMA A	LEKE	347543784	420286104
10	STUDIME E PROJEKTIME	LEKE	10000000	6000000
11	SHPRONSIME	LEKE	4500000	4500000
12	LIDHJA ME SISTEMIN	LEKE	35000000	
13	PAISJE TEKNOLOGJIKE	LEKE	125000000	95000000
14	MONTIME	LEKE	3500000	3000000
15	PROVA DHE VENIE NE PU	LEKE	1200000	1000000
	SHUMA B	LEKE	179200000	109500000
	SHUMA (A+B)	LEKE	526743784	529786104
	Shuma (Stranik +Zall Tore) =		1056529888	Leke



Adresa: Rr. "Durrësit", P.118, Sh.1.Ap.1; Tel: (355) 42 398 72; Mob.: 0682368672

No. 2132 Rep.

Mr. 262 kef.

VERTETIM


Në Tiranë, sot më Dy Korrik 2009 (Dy mijë e nëntë), ditën e enjte, para meje, Notere FATIME B. META, e regjistruar në Dhomën e Noterëve, Tiranë, me zyrë në Rruga "Durrësit", P.118, Sh.1, Ap.1, u paraqitën personalisht:

1) **GENC RULI**, i biri i Pëllumbit, lindur në Tiranë më 11.04.1958, banues në Tiranë, ministër i Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i njohur personalisht prej meje, dhe,

2) **JEMIN GJANA**, i biri i Ramadanit, lindur në Kukës më 15.05.1950, banues në Tiranë, Ministër i Bujqësisë dhe ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i njohur prej meje,

3) Shoqëria "Hidroinvest" Sh.P.K, me seli në Çarshovë, Përmet, e përfaqësuar nga BARDHYL HAZIZAJ, i biri i Dines, lindur në Fier më 15.08.1955 dhe banues në Tiranë, për identitetin e të cilit u sigurova nga dokumentet e Shoqërisë dhe Pasaportës Z1248575., madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

Të lartpërmendurit më deklaruan se Marreveshjen per disa shtesa dhe ndryshime ne Kontraten e Koncesionit të formës "BOT" (Ndertim, Operim, Transferim) të lidhur midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës dhe Shoqërisë "HIDROINVEST" - Sh.P.K për ndertimin e hidrocentraleve në Stranik dhe Zaltore në Komunën Stravaj Librazhd, miratuar me Vendimin №. 565, datë 12.08.2005 të K.M, e kanë redaktuar, nënshkruar dhe vulosur me vullnet të lirë dhe të plotë, jashtë kësaj zyre, ndërsa unë Noterja, vërtetoj nënshkrimet e përfaqësuesëve të palëve kontraktues, në përputhje me Nenin 39 të Ligjit "Për Noterinë".



Fatime B. Meta
E. Fasovci

VENDIM
Nr.776, datë 15.7.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 19 korrik 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 6 (gjashtë) automjete dhe 12 (dymbëdhjetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 24 korrik 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 6 (gjashtë) automjete dhe 12 (dymbëdhjetë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 19 korrik 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 24 korrik 2009, është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

4. Autokolonat ushtarake italiane gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.777, datë 15.7.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KRRABË TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Krrabë, të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Krrabë, të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.1236, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Krrabë të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Krrabë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Krrabë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
72	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
75-79	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
80,81	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve të shëndetit publik	Në pronësi
82-92	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
93-209	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
210-214	Varreza publike	Në pronësi
217-241	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
243-254	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
255,256	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.778, datë 15.7.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS LEKAJ TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Lekaj, të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprase, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Lekaj të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.711, datë 24.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Lekaj të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Lekaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Komuna Lekaj

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-11	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
12,13	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
14-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve të shëndetit publik	Në pronësi
21-24	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
25-44	Shërbime funerale	Në pronësi
45-48,50-53,55-59, 61-64,66-78,555	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
49,54,60,65,79,81,83 85,88,91,93,98,100, 107,110,112,115	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
189-543	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
544-554,556-628	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim

VENDIM
Nr.780, datë 15.7.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KRAHËS TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Krahës të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Krahës, të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.729, datë 23.11.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Krahës, të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komunat Krahës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Krahës

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-4	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
5-7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
8-20	Varrezat publike	Në pronësi
21-118	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
334-337,339-342, 344-347,349-353,355, 357-359,361-364, 366,368,369	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
338,343,348,354,356,360, 365,367,370, 727-736,372,376,379,383, 386,388,394,398,402	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
404-696	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
697-699	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.781, datë 15.7.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E CILA PREKET NGA NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-
VJEÇARE, NË BASHKINË KAMËZ (BATHORE 5), TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “ Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare, në bashkinë Kamëz, (Bathore 5), Tiranë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë Kamëz.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 5 000 (pesë mijë) m², tokë/truall, e vlerësuar me 2 834 (dy mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekë/ m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi 14 170 000 (katërmëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë) mijë lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 273 500 (dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga bashkia Kamëz.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 14 170 000 (katërmëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë) mijë lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit gusht 2009.

7. Bashkia Kamëz të bëjë likuidimin e pronarit, brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe bashkia Kamëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARIT QË DO TË SHËPRONËSOHET SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË
SHKOLLËS 9-VJEÇARE NË BASHKINË KAMËZ**

Pronari	Z.K.	Nr.pas.	Sip. truall	Çmimi truall lek/m²	Vlera tokës (lekë)	Vlerë totale shpronësimi (lekë)
Suat Hysen Jegeni	2066	209/44	5000	2834	14170000	14170000

Vlera totale e shpronësimit është 14 170 000 (katërmëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.

VENDIM
Nr.782, datë 15.7.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E CILA PREKET NGA NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-
VJEÇARE, NË BASHKINË KAMËZ (BATHORE 6), TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare, në bashkinë Kamëz, (Bathore 6), Tiranë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë Kamëz

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 5 000 (pesë mijë) m², tokë/truall, e vlerësuar me 2 834 (dy mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekë/ m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi 14 170 000 (katërmëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë) mijë lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 273 500 (dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga bashkia Kamëz.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 14 170 000 (katërmëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë) mijë lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit gusht 2009.

7. Bashkia Kamëz të bëjë likuidimin e pronarit, brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe bashkia Kamëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARIT QË DO TË SHËPRONËSOHET SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË
SHKOLLËS 9-VJEÇARE NË BATHORE 6, BASHKIA KAMËZ**

Pronari	Z.K.	Nr.pas.	Sip. truall	Çmimi truall lek/m ²	Vlera tokës (lekë)	Vlerë totale shpronësimi (lekë)
Ramazan Demir Nika	2066	189/30	5000	2834	14170000	14170000

Vlera totale e shpronësimit është 14 170 000 (katërmëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.

KËRKEË

Shtetasi Gëzim Dunga, i biri i Ismetit dhe i Lemes, i datëlindjes 12.6.1969, lindur dhe banues në fshatin Eskaj, Lushnjë, kërkon shpalljen të vdekur të xhaxhait të tij Beqir Jonuz Dunga.

KËRKUESI
Gëzim Dunga

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë

Hyri në shtyp më 13.8.2009
 Doli nga shtypi më 14.8.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2009

Çmimi 52 lekë